

 University of Prizren Universiteti Prizren "UKSHIN HOTI"	
Pranuar me	09.12.2022
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
308	01-641

Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren
 University "Ukshin Hoti" Prizren

KËSHILLI DREJTUES

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë, Tel. +381 (0) 29- 232 140, Homepage: www.uni-prizren.com

Kryesues i Këshillit Drejtues
Prof. Asoc. Dr. Arif Murrja

Prizren, më 06.12.2022

Në mbështetje të nenit 17, paragrafi 3 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, duke u bazuar në Rregulloren për shpenzime të veçanta për mbarëvajtje dhe kryerjen e detyrave të punës, nr.01-125/A, datë 23.11.2021, Këshilli Drejtues i Universitetit të Prizrenit, në mbledhjen e mbajtur më 23.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

**PËR PROCEDURËN SHFRYTËZIMIT TË SHPENZIMEVE TË VEÇANTA PËR
 MBARËVAJTE DHE KRYERJEN E DETYRAVE TË PUNËS**

1. Me qëllim të shfrytëzimit të reprezentacionit, për shpenzimet e takimeve zyrtare, kategoritë që i takon për takime zyrtare, sipas nenit 2 të Rregullores për shpenzime të veçanta për mbarëvajtje dhe kryerjen e detyrave të punës, nr. 308, datë 15.04.2021, duhet të parashtrinë kërkesë për realizimin e shpenzimeve të reprezentacionit. Kërkesa duhet të jetë e protokolluar, sipas procedurave.
2. Kërkesa për realizimin e reprezentacionit për takime zyrtare, duhet të parashtrohet tek Rektori i Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, përmes zyrës së Financave, më së largu 24 (njëzet e katër) orë pasiqë është realizuar takimi, në rastet kur takimet nuk kanë qenë të planifikuara paraprakisht. Në rast se takimet janë të planifikuara, sipas një dinamike të parashikueshme, kërkesa për realizimin e reprezentacionit duhet të parashtrohet më herët, respektivisht para se të ndodhë takimi.
3. Pas realizimit të takimit, shpenzimi nga reprezentacioni shoqërohet me faturën përkatëse, së bashku me kuponin fiskal. Fatura përkatëse e realizimit të shpenzimeve të reprezentacionit, dorëzohet përmes Zyrës së Financave, tek Rektori i Universitetit. Fatura duhet të jetë e nënshkruar nga ana e shfrytëzuesit të shpenzimeve të reprezentacionit, sipas nenit 2 të Rregullores nr.01-125/A, datë 15.04.2021.
4. Personat e autorizuar për shfrytëzimin e reprezentacionit, sipas nenit 2 të Rregullores nr.01-125/A, datë 15.04.2021 janë të obliguar që në pjesën e pasme të faturës të shënojnë emrat e pjesëmarrësve në takimin zyrtar si dhe numrin dhe datën e kërkesës të parashtruar, për realizimin e shpenzimeve të reprezentacionit.

5. Me qëllim të ekzekutimit të pagesave, për personat e autorizuar për shfrytëzimin e reprezentacionit, kërkesa përkatëse aprovohet nga Rektori ose Prorektori për Buxhet Financa dhe Infrastrukturë, sipas autorizimit me shkrim nga Rektori.
6. Kërkesa e aprovuar, i dorëzohet për pagesë Zyrës së Financave të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren.
7. Vendimi hyn në fuqi, ditën e miratimit nga ana e Këshillit Drejtues të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren.

Prof. Asoc. Dr. *Arif Murati*

Kryesues i Këshillit Drejtues



Vendimi i'u dërgohet:

- Këshillit Drejtues;
- Menaxhmentit;
- Sekretarit të përgjithshëm;
- Shërbimit financiar;
- Zyrës ligjore;
- Parashtruesit të kërkesës;
- Arkivit.